



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1392/1 Prot.

Durrës më, 8 / 8 / 2024

V E N D I M

Nr. 42, datë 8.8 2024

"PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË STUDIMIT, PËR PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", pika 3/ç ku citohet se: "Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj", Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, Vendimeve respektive të Bordit të Administrimit për miratimin e tariffave të shkollimit, vendimit të Senati Akademik nr.47, datë 30.07.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e shkollimit, për studentët të cilët regjistrohen, në një program të ciklit të dytë të studimeve, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas tabelës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues, të cilët do të regjistrohen për herë të parë në një program të parë studimi të ciklit të dytë, do të jetë 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë.
3. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues të cilët do të regjistrohen për herë të parë në një program të dytë studimi të ciklit të dytë do të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.
4. Tarifa e aplikimit për studentë të cilët do të aplikojnë për të transferuar studimet në një program të parë të ciklit të dytë nga një universitet tjetër në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës do të jetë 3 000 (tre mijë) lekë.
5. Tarifa e aplikimit për studentë të cilët do të aplikojnë për të transferuar studimet në një program të dytë të ciklit të dytë nga një universitet tjetër në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës do të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.
6. Studentët të cilët do të regjistrohen në një program studimi të ciklit të dytë me 120 kredite, (me kohëzgjatje normale dy vjecare) do të paguajnë tarifën e shkollimit në tre këste. Kësti i parë, në masën 25% të tarifës së plotë, **do të paguhet menjëherë në momentin e regjistrimit**, kësti i dytë në masën 25% të tarifës së plotë të shkollimit do të paguhet para fillimit të semestrit të dytë, të vitit të parë të studimeve dhe kësti i tretë në masën 50% të tarifës së shkollimit do të paguhet para fillimit të vitit të dytë të studimeve.
7. Studentët të cilët do të regjistrohen në një program studimi të ciklit të dytë me 60 kredite, (me kohëzgjatje normale një vit akademik ose dy semestra) do të paguajnë tarifën e shkollimit në dy këste. Kësti i parë, në masën 50% të tarifës së plotë, do të paguhet

menjëherë në momentin e regjistrimit dhe kësti i dytë para fillimit të semestrit të dytë, të studimeve.

8. Tarifa e shkollimit për kandidatët, që kanë përfunduar me sukses një program të parë studimi dhe përfitojnë të drejtën të ndjekin një program të dytë studimi, do të jetë sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
9. Shtetasit e huaj të cilët do të vazhdojnë studimet pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës në një program të dytë studimi, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë të cilët vijojnë studimet në programet respektive, me përjashtim rasteve kur, me marrëveshje zyrtare janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit për këta studentë.
10. Studentët e ciklit të dytë të studimeve paguajnë vetëm tarifën e plotë të shkollimit sipas krediteve të fituara.
11. Kategoritë e studentëve të cilët vijonë studimet në një program të parë të ciklit të dytë dhe do të përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit do të jenë sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018.
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

